



QENDRA PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TE FEMIJEVE NE SHQIPERI

Children's Human Rights Centre of Albania - CRCA



Tiranë më, 28. 02. 2007

FTESE

TAKIM KONSULTATIV I OJF-ve

PERGATITJA E RAPORTIT ALTERNATIV PER KONVENTEN E TË DREJTAVE TE FEMIJEVE - KDF

Dt. 7 Mars 2007 / Ora 10 / Salla e Takimeve e CRCA

Të nderuar miq dhe kolegë,

Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri – CRCA është një organizatë joqeveritare, jopolitike, jofetare dhe jofitimprurëse që ka si mision të saj mbrojtjen dhe zhvillimin e të drejtave të fëmijëve në vend, si dhe rritjen e pjesmarrjes së fëmijëve në vendimmarrje në nivel lokal dhe kombëtar, nëpërmjet lobimit dhe advokatësisë, përmirësimit të politikave dhe legjislacionit, si dhe forcimit të kapaciteteve të Qeverisë dhe OJF-ve për të punuar në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve.

CRCA është një nga organizatat e para në Shqipëri që është përfshirë dhe ka udhëhequr procesin e përgatitjes së Raporteve Alternative për Konventat e të drejtave të njeriut pranë komiteteve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB). Deri më sot CRCA në bashkëpunim me një sërë organizatash kryesore të shoqërisë civile në Shqipëri kanë përgatitur Raportin Alternativ për Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës, Konventën Kundër Torturës, Konventën Kundër Diskriminimit Racial dhe Paktin për të Drejtat Civile dhe Politike. Ndërkohë në vitin 2006 së bashku me një grup të madh OJF-sh Kombëtare në Shqipëri, inçiuam krijimin e Koalicionit për Përgatitjen e Raporteve Alternative, që solli si rezultat përgatitjen e Raportit të parë Alternativ për Konventën Kundër Diskriminimit ndaj Grave.

Duke patur parasysh se gjatë vitit 2007 dhe në vazhdim shteti shqiptar duhet të raportojë pranë disa komiteteve të OKB-së lidhur me situatën e të drejtave të njeriut, grave, fëmijëve dhe minoriteteve në Shqipëri, CRCA ka menduar që të iniciojë procesin e përgatitjes së Raporteve Alternative për këto konventa:

1. Raport Alternativ për Konventën për të Drejtat e Fëmijës (viti 2007);
2. Raport Alternativ për Konventën Kundër Diskriminimit Racial (viti 2007-2008);
3. Raport Alternativ për Konventën Kundër Torturës (viti 2008).

Duke patur parasysh se procesi i përgatitjes së Raporteve Alternative kërkon përfshirjen e të gjithë partnerëve social nga shoqëria civile, si dhe duke u bazuar në eksperiencën pozitive të Koalicioni për Përgatitjen e Raporteve Alternative gjatë vitit të kaluar në përgatitjen e raportit alternativ për konventën e CEDAW-t, CRCA ka menduar që po nga ky koalicion të krijohet një grup pune për përgatitjen e Raportit Alternativ për Konventën për të Drejtat e Fëmijës. Kjo iniciativë e CRCA është pjesë e programit 'Të Drejtat e Fëmijëve një e Drejtë Demokratike', të financuar nga Olof Palme International Center dhe SIDA.

Meqenëse Konventa për të Drejtat e Fëmijës është e para në listën e raporteve që duhet të përgatiten dhe dorëzohen nga Qeveria shqiptare pranë OKB-së gjatë 2007-s, CRCA ka kënaqësi që t'ju ftojë të merrni pjesë në

një takim koordinues të të gjithë partnerëve të interesuar. **Takimi Koordinues zhvillohet në Sallën e Takimeve të CRCA, në datën 7 Mars 2007, ora 10.00.**

Gjatë këtij takimi do të diskutohet rreth koordinimit të OJF-ve në përgatitjen e Raportit Alternativ për Konventën e të Drejtave të Fëmijës , organizimit të punës dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me raportin.

Në këtë takim janë të ftuar të marrin pjesë të gjitha organizatat që dëshirojnë të bëhen pjesë e këtij procesi, duke patur parasysh edhe fushën e ekspertizës së secilës organizatë. Duke patur parasysh se pjesa kryesore e takimit do të fokusohet tek KDF-ja, ne do të shihnim me interes të veçantë pjesëmarrjen e organizatave të fëmijëve, të të drejtave të njeriut, të minoriteteve si dhe sindikatave.

Për çdo informacion shtesë ju lutem mos hezitoni të kontaktoni me ne.

Sinqerisht

Av. Altin Hazizaj
Drejtor i CRCA

Adresa e zyrave: Pallatet e Shallvareve, Vila mbrapa Fushave të Tenisit, kati i 2-të, Tiranë

Adresa postare: Kutia Postare 1738, Tirana / Albania

Tel/fax: 04 242264

E-mail: crca@crca.org.al

www.crca.org.al